

VENDIM
Nr. 468, datë 31.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 16, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2025 NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETETËRORE, PJESE TË SHËRBIMIT
CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 16, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi për vitin 2025 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) në paragrafin e parë, togfjalëshi “...gjithsej 1186...” zëvendësohet me “... gjithsej, 1196...”;
- b) në shkronjën “a”, numri “5” bëhet “15”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku